## BASHKIA TIRANË

NJOFTIM FITUESI
(MINIKONKURS)

OPERATORIT EKONOMIK "RATECH" SHPK
Adresa: Rruga e Kavajes, Pallatet e Shoqerise Park Construction Albania, Godina D, Hyrja A, Kati 1, Tiranë

Procedura e prokurimit: "E hapur mbi kufirin e lartë monetar/ Marrëveshje kuadër" Me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-82877-10-09-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rritja e kapaciteteve TIK të infrastrukturës qendrore (datacenter) dhe rritja e kapaciteteve për përdoruesit fundorë" Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara

me vlerë të pritshme të kontratave 66,555,937 (gjashtëdhjetë e gjashtë million e peseqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në zhvillimin e minikonkurencës për proçedurën e mësipërme këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori "RATECH" sh.p.k NUIS L11521021S
Çmimi total i ofertës pa tvsh = 21,998,000 (njëzetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë

2. Operatori ekonomik "BNT ELECTRONICS" sh.p.k NUIS J61817047D
Çmimi total i ofertës pa tvsh = 22,989,000 (njëzetë e dy milion e nëntëqind e teëdhjetë e nënëtë mijë) lekë

Nga pjesërmarrësit është s'kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori ekonomik "BNT ELECTRONICS" sh.p.k NUIS J61817047D

Për arsyet e mëposhtme:
Nga verifikimi i kryer ofertës ekonomike të vënë në dispozicion nga Operatori Ekonomik BNT Electronics, verehet se cmimi për njësi i ofruar për artikujt e kërkuar e kalon cmimin për njësi te ofertuar po nga ky operator ekonomik gjatë zhvilllimit të procedurës së prokurimit për lidhjen e Marrëveshjes Kuadër. Për këtë arsye, në bazë të udhëzimit nr 6 datë 16.01.2018 për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pikës 12.3 ku është përcaktuar se: "sasitë e parashikuara janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e detyrojnë autoritetin kontraktor që të blejnë ndonjë prej tyre. Autoriteti mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (por në cdo rast brenda vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër). Kontraktuesit nuk do t'í jepet e drejtapër kompensim dhe nuk do të lejohet të kërkojë rrijen e cmimit për njësi……..", si dhe referuar përcaktimeve të bëra në ftesën për ofertë , ku ndër të tjera citohet se:
Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese janë:
X Çmimi më i ulët
*Vlerësimi i ofertës/ofertave do të bëhet duke u bazuar në ofertën me çmimin më të ulët.
Por në çdo rast ofertuesit nuk duhet të tejkalojnë çmimin për njësi të deklaruar në ofertat eshpallura fituese. Në rast të kundërt oferta Juaj do të s'kualifikohet.
u konkludua në s'kualifikimin e ofertës së paraqitur për këtë procedurë minikonkursi duke e konsideruar atë si të pavlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si oferta e suksesshme:Operatori ekonomik "RATECH" sh.p.k NUIS L11521021S
Çmimi total i ofertës pa tvsh = 21,998,000 (njëzetë e një milion e nënëtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë

Në mbështetje të nenit 110 pika 4 e ligjit Nr 162/2020 per "Prokurimin Publik" si edhe nenit 65 pika 3 dhe nenit 97 pika 4 gërma (a) të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave te prokurimit publik" (i ndryshuar) do të priten afatet e ankimimit nga palët e interesuara në lidhje me vlerësimin e kryer nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në proçesin e minikonkursit.